



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0054

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së “Profitech” SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me Polielektrolit anjonik” me numër të prokurimit 70433736-23-13535-1-3-6, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “Kompania Ujësjiellësi Rajonal Prishtina” SH.A., më 22/03/2024, mori këtë:

Vendim

1. **Refuzohet**, i e pabazuar ankesa e “Profitech” SH.P.K. me nr. 2024/0054 , e datës 17/01/2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me Polielektrolit anjonik”, me numër të prokurimit 70433736-23-13535-1-3-6, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “Kompania Ujësjiellësi Rajonal Prishtina” SH.A..

2. Vërtetohet Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues – “Kompania Ujësjiellësi Rajonal Prishtina” SH.A., lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit.

3. Urdhërohet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 05.12.2023, “Kompania Ujësjiellësi Rajonal Prishtina” SH.A., në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me

titull “Furnizim me Polielektrolit anjonik” me numër të prokurimit 70433736-23-13535-1-3-6. Ndërsa me datën 05.01.2024 AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë OE “Aquatic SH.P.K.”

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës **9,900.00 €**.

Me 09.01.2024, OE “Profitech” SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 11.01.2024, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 17.01.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Profitech” SH.P.K., me nr. 2024/0054 lidhur me aktivitetin “Furnizim me Polielektrolit anjonik” me numër të prokurimit 70433736-23-13535-1-3-6.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Profitech” SH.P.K., janë parashtruar si në vijim: pretendimet e OE ankues: “Bazuar në “Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues” të datës: 05.01.2024, vendimi i marr nga Komisioni Vlerësues është i pa bazuar;

Për informatën tuaj më datë: 26.12.2023, na është dërguar përmes platformës e-prokurimi “Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues” në të cilin vendim kompania jonë “Profitech” sh.p.k. është rekomanduar për kontratë.

Pas këtij vendimi më datë 05.01.2024, na është dërguar përmes platformës e-prokurimit “Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues” ku Autoriteti Kontraktues shpërblen me kontratë një OE tjetër i cili është me çmim më të lartë se çmimi i ofertuar nga ana jonë si dhe na është dërguar “Letra Standarde për Tenderuesin e Eliminuar” ku arsyetimi i eliminimit tonë nga ana e Autoriteti Kontraktuese është bazuar në Kërkesën për Rishqyrtim e cila është bërë nga një Operator Ekonomik tjetër me çmimin më të lartë të ofertës nga të gjithë OE të tjerë pjesëmarrës.

Ne jemi eliminuar nga Autoriteti Kontraktues për arsyetimin si më poshtë: Dokumentacioni i kërkuar nga prodhuesi (Specifikacioni teknik) nuk është dorëzuar. Mungon dokumenti për verifikimin e Mesi i pH-se efektiv 3-11 (me efektiv ka mesi alkaline) Bazuar ne Rregulloren Nr.001_2022 për prokurimin publik, Neni 38, Sqarimi i Tenderëve; Autoriteti Kontraktues është dashur që të bënte një “Kërkesë për Sqarimin e Tenderit” e jo automatikisht të procedohet me

eliminim.

Sqarim: Produkti i ofruar nga ana jonë: Superfloc® A-110PWG nga Prodhuesi i njohur botërisht Kemira Oyj, i plotëson të gjitha kriteret dhe rregulloret siç janë në përputhshmëri me standardin CEN 1407:2008 i cili dëshmon se polielektroliti i ofruar përdoret për trajtimin e ujit të destinuar për konsum njerëzor.

Prodhuesi Kemira Oyj, është themeluar në vitin 1920 me përvojë mbi 100 vite ku është e renditur njëri nga të parët nga Top prodhuesit më të mëdhenj global sa i përket prodhimit të kimikateve për trajtimin e ujërave.

Të njëjtin produkt Superfloc® A-110PWG e kemi liferuar për vite me radhe tek AK KUR Prishtina SH.A. si dhe kemi pranuar referenca për liferimin e produktit në fjalë. Për të dëshmuar se Produkti i ofruar nga ana jonë Superfloc® A-110PWG është në përputhshmëri me kërkesat sipas specifikacionit teknik në dosje të tenderit gjegjësisht Mesin e pH-se efektiv 3-11, të bashkëngjitur mund të gjeni Deklaratën nga Prodhuesi Kemira.

Po ashtu në dokumentacionin e ofruar nga ana jonë: 3. TDS_Superfloc A[1]110PWG_EN.pdf, në faqe Nr. 1, tek Benefits (Përfitimet) është e cekur: Effective over a wide range of pH; does not alter the system pH. (Është Efektiv në një gamë të gjerë të pH-së: nuk ndryshon pH-në e sistemit) Që do të thotë se produkti i ofruar Superfloc® A-110PWG operon në mënyre efektive në një gamë të gjerë të pH-së pa e ndryshuar pH-në e sistemit.

Vlen të cekët po ashtu se çmimi i ofruar nga ana jonë është për 1,575.00 € rreth (17 %) më i ulët se OE i rekomanduar për kontratë, ku AK në bazë të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 sipas Neni 1 Qëllimi, ka për qëllim të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera. dhe Neni 6 Ekoniciteti dhe Efikasiteti, paragrafi 1, ku: Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit”.

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin Neni 1, 6, 7, 59, të LPP –së, si dhe 38 të rregullores se prokurimit publik. Duke propozuar që të APROVOHET si e bazuar Ankesa e OE “Profitech sh.p.k.” ANULOHET Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të publikuar më datë: 05.01.2024, lënda të kthehet në rivlerësim dhe më pas të ri-shpallet fitues OE “Profitech sh.p.k.”.

Përgjigjja e AK ndaj kërkesës për rishqyrtim: “Te pretendimi i juaj “Është Efektiv në një gamë të gjerë të pH-së: nuk ndryshon pH-në e sistemit” Pretendimi i juaj nuk qëndron për arsye se, këtu nuk është cekur rangi 3-11. Pra mungon specifikacioni teknik nga ana e prodhuesit. Ne Udhëzuesin e Prokurimit nr.001/2023, pjesa 10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve, faqe 41, mes tjerash thuhet kjo: Mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm Prandaj, duke pasur parasysh këtë që u

cek me lart, Autoriteti Kontraktues konsideron këtë Kërkesë Për Ri-Shqyrtim Si Të Pa-Bazuar.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 26/01/2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0054/24, ndërsa me datë 05/02/2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0054 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, nuk pajtohet, po ashtu OE nuk pajtohet rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “Profitech” SH.P.K., ekspertja shqyrtuese përmes raportit nr. 2024/0054 ka vlerësuar si në vijim: “Aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me Polielektrolit anjonik” me nr. të prokurimit: “70433736-23-13535-1-3-6”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “Kompania Ujësjiellësi Rajonal Prishtina” SH.A., ka filluar me njoftimin për kontratë me datë 05.12.2023, hapja e ofertave është bërë me datë 12.12.2023, njoftimi B58 publikohet me datë 26.12.2023, ku rekomandohet për kontratë OE ankuesi “Profitech” SHPK, gjersa pas kërkesës për rishqyrtim nga OE, si rezultat i aprovimit të kërkesës për rishqyrtim nga AK, aktiviteti i prokurimit kthehet në rivlerësim, ku me datë 05.01.2024 AK publikon vendimin B58- rekomandon OE “Aquatic” SHPK.

OE ankuesi eliminohet me arsyetimin: Dokumentacioni i kërkuar nga prodhuesi (specifikacioni teknik) nuk është dorëzuar, Mungon dokumenti për verifikimin e Mesi i pH-së efektive 3-11 (me efektiv është ka mesi alkaline).

Tutje, i njëjti i pa kënaqur me vlerësimin e AK-së, pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim, me datë 19.01.2024 parashtroi ankesë pranë OSHP-së, duke pretenduar se AK ka eliminuar pa drejtësi dhe se gjatë vlerësimit të ofertave ka shkelë LPP-në përkatësisht nenet: 1,6,7,59, dhe nenin 38 të rregullores nr 001/2022.

Pretendimi i OE ankues kundër arsyes së eliminimit: Sqarim: Produkti i ofruar nga ana jonë: Superfloc® A-110PWG nga Prodhuesi i njohur botërisht Kemira Oyj, i plotëson të gjitha kriteret

dhe rregulloret siç janë në përputhshmëri me standardin CEN 1407:2008 i cili dëshmon se polielektroliti i ofruar përdoret për trajtimin e ujit të destinuar për konsum njerëzor.

Prodhuesi Kemira Oyj, është themeluar në vitin 1920 me përvojë mbi 100 vite ku është e renditur njëri nga të parët nga Top prodhuesit më të mëdhenj global sa i përket prodhimit të kimikateve për trajtimin e ujërave.

Të njëjtin produkt Superfloc® A-110PWG e kemi liferuar për vite me radhe tek AK KUR Prishtina SH.A. si dhe kemi pranuar referenca për liferimin e produktit në fjalë. Për të dëshmuar se Produkti i ofruar nga ana jonë Superfloc® A-110PWG është në përputhshmëri me kërkesat sipas specifikacionit teknik në dosje të tenderit gjegjësisht Mesin e pH-se efektiv 3-11, të bashkëngjitur mund të gjeni Deklaratën nga Prodhuesi Kemira.

Po ashtu në dokumentacionin e ofruar nga ana jonë: 3. TDS_Superfloc A110PWG_EN.pdf, në faqe Nr. 1, tek Benefits (Përfitimet) është e cekur: Effective over a wide range of pH; does not alter the system pH. (Është Efektiv në një gamë të gjerë të pH-së: nuk ndryshon pH-në e sistemit) Që do të thotë se produkti i ofruar Superfloc® A-110PWG operon në mënyre efektive në një gamë të gjerë të pH-së pa e ndryshuar pH-në e sistemit.

Ekspertja Shqyrtuese pas analizimit, shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, AK në DT përkatësisht në Aneks 1 tek specifikat teknikë të detyrueshme ka kërkuar: Kurse specifikat e ofruara nga OE janë si më poshtë, në të cilën vërehet se nuk janë konform kërkesës, pra mesi i PH-se efektive 3-11 mungon, si e tillë pretendimi i OE ankues nuk gjendet i bazuar.”

Sipas të thënave më sipër, ekspertja shqyrtuese i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Profitech” SH.P.K., Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtuese është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin raportit të ekspertes shqyrtuese. Me këtë rast Paneli Shqyrtues ka marrë në konsideratë edhe përgjigjen e dhënë nga OE ankues. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Profitech” SH.P.K., janë tëpa bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesës, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtrësat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior. Në këtë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit, sikurse Ankesat në këtë rast.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktiviteti të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertes shqyrtuese dhe mendimi i saj janë të pranueshme dhe se Paneli

me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes pa nevojë që të njëjtat të përsëriten sërish, po ashtu paneli shqyrtues e mori për bazë edhe përgjigjen e autoritetit kontraktues në kërkesën për rishqyrtim e cila e evidenton mungesën e një pjese të specifikacionit teknik në ofertën e ankuesit dhe e refuzon ankesën duke e bazuar në Udhëzuesin nr. 001/2023 për Prokurim Publik.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertës shqyrtuese, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertës shqyrtuese. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të pabazuara. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – “Kompania Ujësjiellësi Rajonal Prishtina” SH.A., të datës 05.01.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me Polielektrolit anjonik” me nr. të prokurimit: 70433736-23-13535-1-3-6.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL PRISHTINA SH.A.**
- **OE - " Profitech " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: